

Nr. 4050 d. 31.10.2023



TrafikuUrban
PRISHTINË

N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. Prishtinë
Plani i Biznesit për vitin 2024 - 2026



Përbajtja

Parathënie.....	4
1. Detaje mbi regjistrimin e ndërmarrjes	6
1.1. Aktivitetet e ndërmarrjes:	6
2. Të dhëna mbi ndërmarrjen.....	6
3. Lokacioni i ndërmarrjes	6
4. Përbledhje Ekzekutive	7
4.1 Situata aktuale dhe ndryshimet e planifikuara	7
4.2 Lëvizja dhe rritja e popullsisë në Kryeqytet.....	7
4.3 Ndërmarrje e besueshme e transportit publik.....	7
4.4 Sfidat financiare dhe inovacioni teknologjik	7
4.5 Plani dhe objektivat - përmirësimi i shërbimit, diversifikimi i burimeve dhe stabiliteti finansiar.....	8
4.6 Në qendër të planit - përmirësimi i shërbimit dhe zhvillimi i qytetit.....	8
4.7 Menaxhimi i borxhit.....	9
4.8 Bashkëpunimi me Komunën	9
4.9 Marrëveshje me ndërmarrje publike dhe kompani private.....	10
5. SWOT analiza	11
6. Drejtoria e Financave	12
7. Drejtoria e Operativës	13
7.1 Sektori i Transportit	13
7.1.1. Propozimet për linjave të reja.....	15
7.1.2. Plotësime funksionale dhe modernizimi i sistemeve të transportit	15
7.1.3. Zgjerimi i zonave të operimit	16
7.2. Sektori i mirëmbajtjes	16
7.3 Renovimi i objektit dhe kiosqeve.....	21
7.4 Sektori i Shërbimeve Mbështetëse	22
8. Drejtoria e Administratës	24
8.1 Burimet Njerëzore	24
8.1.1 Struktura organizative e ndërmarrjes – Organogrami	26
8.2 Plani i Teknologjisë Informatike	27
8.2.1 General Softëare	27

8.2.2 ËiFi Falas në Autobusë	27
8.2.3 Sistemi i Ri i Pagesës	27
8.2.4 Sistemi Akustik në Autobusë	29
8.3 Plani i Marketingut	29
8.3.1. Plani i promovimit të produkteve të reja	29
8.3.2. Rritja e kualitetit të shërbimeve	30
8.3.3. Digitalizimi i biletave	30
8.3.4 Planifikimi për marketing komercial	33

Parathënie

Jam i lummur të prezantoj Planin Vjetor të Biznesit të Trafikut Urban për vitin 2024 - 2026. Një dokument zyrtar që përfshin angazhimin tonë të palëkundur ndaj vizonit tonë themelor: ofrimi i një shërbimi të shkëlqyeshëm, përmirësimi i kushteve të punës dhe arritjen e një performance të përgjithshme më të mirë dhe efikase.

Përveç këtyre shtyllave, së bashku me ekipin menaxhues të ndërmarrjes kemi përfshirë objektiva strategjike për rritjen e performancës të përgjithshme, rritjen e shitjeve të biletave, diversifikimin e operacioneve tona për të krijuar burime të tjera të të ardhurave, si dhe disa iniciativa të reja të cilat përfshijnë:

- Rritja e Flotës së Autobusëve:** Një iniciativë e rëndësishme e përmirësimit të shërbimeve tona është vendimi për blerje e 30 autobusëve të ri, prej të cilëve, 6 autobusë do të janë elektrikë, duke e çuar numrin e autobusëve në 81. Ky hap do të ulë ndotjen e mjedisit dhe do të sigurojë një shërbim më efikas për udhëtarët tanë.
- Sistemi i Komunikimit të Integruar:** Implementimi i një sistemi të ri të komunikimit do të lejojë një bashkëveprim më të mirë mes shoferëve dhe operatorëve të shërbimit, gjegjësisht dispeçerëve. Kjo do të rrit efikasitetin dhe sigurinë e udhëtimit.
- Sistemi i Integruar i Menaxhimit - software i menaxhimit të përgjithshëm:** Për të përmirësuar efikasitetin e operacioneve tona, ne do të pajisemi me sistem operativ të integruar (software) të menaxhimit që do të përmirësonte menaxhimin e përgjithshëm të ndërmarrjes dhe rriste transparencën në zinxhirin e operacioneve operative dhe administrative.
- Shërbim dhe Infrastrukturë më të mirë për personat me aftësi të kufizuara:** Përmirësimi i shërbimit dhe infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuara është një hap i rëndësishëm drejt shërbimit më të mirë dhe të barabartë për të gjithë udhëtarët tanë. Kjo përfshin një sistem operativ të integruar (software) që do të ndihmoj dhe përmirësoj eksperiencën e udhëtimit me autobusët tanë.
- Sistemi i Ri i Pagesës Digitale:** Përmes planit të mobilitetit nga Drejtoria e Shërbimeve Publike; zhvillimin i një sistemi të ri të pagesës elektronike, si alternativë e re për blerje të biletave, duke u përshtatur me nevojat e udhëtarëve në epokën digitale. Për më shumë digitalizimi do të zëvendësonte nevojën e pajisjes me biletë nga personat fizik (biletashítësit) duke ulur dukshëm numrin e punëtorëve në ndërmarrje.
- Wi-Fi Falas:** Instalimi i Wi-Fi falas në autobusë si mjet i rëndësishëm për promovim të shërbimeve tona, njëkohësisht vlerë e shtuar që tregon kujdesin tonë ndaj qytetarëve.
- Promovimin e Sistemit të Ri të Pagesës me SMS:** Forma e re e pagesës së biletës përmes SMS ka filluar nga data 1 tetor 2023. Promovimi i kësaj forme do të njoftonte qytetarët për alternativën e re të blerjes së biletave me SMS përmes operatorëve telefonikë vendor.

Roli i ndërmarrjes siç edhe dihet është ofrimi i shërbimeve të transportit publik urban për qytetarët e Kryeqytetit. Ky plan shërben si kompas për strategjinë tonë, duke përkufizuar drejtimin që do të ndjekim gjatë vitit të ardhshëm dhe objektivat kryesore që do të na udhëheqin.

Prioritetet tona janë si vijon:

- **Shërbimi i Shkëlqyeshëm:** Do të vazhdojmë të përmirësojmë dhe inovojmë shërbimet tona, duke siguruar që udhëtarëve të ju ofrojmë shërbime të sigurta, të besueshme dhe efikase.
- **Rritja e numrit të udhëtarëve:** Do të mbesim të përkushtuar që të rrisim numrin e udhëtarëve dhe rritjen e gamës së shërbimeve.
- **Përmirësimi i Mirëqenies së Punëtorëve:** Do të fokusohemi në ngritjen e mirëqenies së punonjësve, duke ofruar një mjeshtësi më të mirë dhe inkurajues, si dhe mundësi për zhvillim personal dhe profesional.
- **Optimizimi i Performancës:** Do të ndjekim me vendosmëri secilin proces, duke pasur prioritet përgjegjësinë financiare, qëndrueshmërinë mjeshtësore dhe performancën e përgjithshme.
- **Rritja e Shitjeve:** Në bashkëpunim me DSHP do të zbatojmë strategji për të rritur shitjet dhe të ardhurat tona, duke përfshati irë fushata marketingu, oferta të reja të shërbimeve dhe çmimit të biletave.
- **Diversifikimi i Operacioneve:** Për të forcuar stabilitetin financiar, do të kërkojmë mundësi për të diversifikuar operacionet tona dhe burimet e të ardhurave përtej shërbimeve tona të transportit bazë. Kjo mund të përfshijë investime në sektorë të ndryshëm, si logistikë, iniciativa të qytetit ose forma të tjera të operimit.
- **Qëndrueshmëria Mjeshtësore:** Do të vazhdojmë të jemi të angazhuar dhe të zvogëlojmë ndotjen e mjeshtësive edhe më shumë duke investuar në teknologji dhe duke vazhduar promovimin e praktikave të përgjegjshme dhe të qëndrueshme.

Ky Plan Vjetor i Biznesit është projektuar si mjet dinamik dhe strategjik, që udhëzon përpjekjet tona gjatë gjithë vitit dhe shërben si një mjet komunikimi transparent për të gjithë investorët. Do të rishqyrtojmë vazhdimeshit progresin tonë dhe do të adaptojmë strategjitë tona sipas nevojave për të arritur këto objektiva.

Vitin 2024 na pret së bashku me përpjekjet tona për të ofruar një shërbim më të mire për qytetarët, për të mbështetur punonjësit tanë, për të shfaqur performancë më të mirë dhe gjithashtu për të zgjeruar horizontet tona dhe për të përforcuar bazat tona financiare.

Faleminderit për mbështetjen dhe angazhimin tuaj të vazhdueshëm.

Burim Maraj

Kryeshef Ekzekutiv, 31 tetor 2023

1. Detaje mbi regjistrimin e ndërmarrjes

Emri i biznesit:	N.P.K. "TRAFIKU URBAN" SH.A.
Lloji i biznesit:	Shoqëri Aksionare
Vendndodhja e biznesit:	Rr."Tahir Zajmi" nr.43, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Viti i regjistrimit:	1976

1.1. Aktivitetet e ndërmarrjes:



- Transporti rrugor urban dhe ndër urban i pasagjerëve
- Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve
- Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve
- Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to.

2. Të dhëna mbi ndërmarrjen

NPK "Trafiku Urban" SHA në Prishtinë ushtron veprimtarinë e transportit për udhëtarë në linjat urbane dhe urbane-periferike me qëllim të organizimit dhe lehtësimit të jetës së qytetarëve dhe hyr në rangun e veprimtarive tjera shërbyses komunale.

Për shkak të rëndësisë që ka, ky shërbim ka filluar të ofrohet në mënyrë të organizuar nga Komuna e Prishtinës nga data 01.04.1976 kur edhe "Trafiku Urban" SH.A u themelua si Ndërmarrje Publike Komunale.

3. Lokacioni i ndërmarrjes

Trafiku Urban ndodhet në rrugën "Tahir Zajmi" e cila është në jugperëndim të qendrës së Prishtinës.

Parcela e tokës që përfshin hapësirat e brendshme dhe të jashtme të ndërmarrjes është afersisht $30,550 \text{ m}^2$ (e brendshme) dhe rrëth $17,000 \text{ m}^2$ (e jashtme).

Një pjesë e kësaj hapësire e cila tani është e pashfrytëzuar është e destinuar për zgjerimin e parkingut për autobusët e rinj.

4. Përbledhje Ekzekutive

Me krenari, ju paraqesim Pasqyrën Ekzekutive të Planit Vjetor të Biznesit të Ndërmarrjes Publike Trafiku Urban për vitin 2024 - 2026. Ne ndejmë një përgjegjësi të thellë ndaj qytetarëve dhe vizitorëve të Prishtinës, dhe ky plan shfaq përkushtimin tonë për të siguruar një shërbim të shkëlqyer në fushën e transportit publik.

4.1 Situata aktuale dhe ndryshimet e planifikuara

Shërbimi i transportit publik për qytetarët e Prishtinës është një nevojë e padiskutueshme. Me një flotë prej 51 autobusësh të ndarë në 9 linja, ofrojmë shërbim çdo ditë për një numër të lartë udhëtarësh. Për të përmirësuar më shumë shërbimin tona, kemi planifikuar blerjen e 30 autobusëve të rinj, përfshirë 6 autobusë elektrikë, duke e zgjeruar flotën tonë në 81 autobusë. Ky ndryshim jo vetëm që do të ndikoj në mbrojtën e ambientit, por gjithashtu do të sigurojë një shërbim sa më të mirë për udhëtarët tanë.

4.2 Lëvizja dhe rritja e popullsisë në Kryeqytet

Prishtina ka shënuar një rritje të shpejtë të popullsisë veçanërisht në vitet e fundit. Si pasoje e kësaj rritje është shtuar edhe kërkesa për shërbimet tona, prandaj ne po punojmë në shtimin e kapaciteteve për të ofruar shërbime për të gjithë qytetarët.

4.3 Ndërmarrje e besueshme e transportit publik

Trafiku Urban vazhdon të mbetet një lider në ofrimin e shërbimeve të transportit publik për banorët dhe vizitorët e Prishtinës. E gjithë kjo fal angazhimit dhe përkushtimit tonë maksimal për ofrimin e shërbimit sa më efikas, flotës tonë të autobusëve si dhe kapaciteteve njerëzore dhe atyre teknike.

4.4 Sfidat financiare dhe inovacioni teknologjik

Në vitin e kaluar ndërmarrja është përballur me sfida financiare, si rezultat i krizës globale dhe ngritjes së çmimeve në përgjithësi. Megjithatë, kemi reaguar me përgjegjësi, duke reduktuar investimet kapitale dhe operative për të menaxhuar situatën. Po ashtu, synojmë përmirësimin e shërbimit përmes investimeve në teknologji të re, trajnimit të punonjësve, dhe rritjes së cilësisë së shërbimit për udhëtarët tanë.




4.5 Plani dhe objektivat - përmirësimi i shërbimit, diversifikimi i burimeve dhe stabiliteti financiar

Përmes këtij Plani të Biznesit, këtë vit synojmë vijueshmërinë e suksesit tonë. Ne do të vazhdojmë me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm duke ndjekur praktikat më të mira evropiane për të siguruar një shërbim më të mirë për komunitetin tonë. Objktivi ynë është i orientuar në dy rrafshe: përmirësimi i shërbimit për të gjithë udhëtarët, diversifikimi i burimeve për të krijuar të ardhura shtesë për kompaninë që na mundëson stabilitetit financiar.

Kjo do të na ofrojë mundësinë për të rritur pagat dhe për të ofruar kushte më të mira për punonjësit tanë, duke kontribuar në përmirësimin e shërbimit dhe performancës së përgjithshme të ndërmarrjes.

4.6 Në qendër të planit - përmirësimi i shërbimit dhe zhvillimi i qytetit

Objktivi ynë kryesor është përmirësimi i shërbimit të transportit publik për të gjithë. Kjo përfshin investime në teknologji të re, trajnimin e punonjësve tanë, dhe rritjen e cilësisë së shërbimit për qytetarë. Kemi parasysh sfidat dhe mundësitë që ofron lëvizja e popullsisë, saktësish rritja e popullsisë në zona urbane, dhe jemi të vendosur të jemi partner i besueshëm në zhvillimin e Prishtinës.



Figurë 4.1 – Ilustrim

4.7 Menaxhimi i borxhit

Menaxhimi i borxhit ndaj BERZH është përkushtim thelbësor që ndikon në qëndrueshmërinë financiare të Trafiku Urban. Për të siguruar që këto pagesa të realizohen në afatin e paraparë dhe të jenë në harmoni me të ardhurat e ndërmarrjes, planifikimi buxhetor për vitin 2024 - 2026 përfshin:

- **15 korrik 2024 - Kësti i 13 i kredisë së parë:** Kjo është një pagesë e rëndësishme që synon të mbulojë detyrimet ndaj kredisë së parë.
- **15 nëntor 2024 - Depozitë DSRA (rreth 600.000,00 €):** Depozita e ruajtjes së detyrimit siguron që Trafiku Urban do të ketë mjetet e nevojshme për të plotësuar pagesën e kredisë në afat.
- **15 janar 2025 - Kësti i 14 i kredisë së parë:** Kjo pagesë e re ndihmon në zhvillimin e planit financier për të përballuar detyrimet.
- **15 shkurt 2025 - Kësti i parë i kredisë së dytë:** Pagesa për kreditin e dytë fillon këtu, dhe është e rëndësishme të planifikohet në vitin 2024.

4.8 Bashkëpunimi me Komunën

Për të siguruar që ndërmarrja të ketë zhvillim dhe performance të mirë, përkrahja e Komunës është thelbësore. Bashkëpunimi dhe marrëveshjet me Komunën janë të domosdoshme dhe ndihmojnë në sigurimin e burimeve dhe përkrahjes së nevojshme për të realizuar pagesat me sukses dhe për të garantuar stabilitetin financier të ndërmarrjes.



Figurë 4.2 - Foto nga autoparku i Trafikut Urban

4.9 Marrëveshje me ndërmarrje publike dhe kompani private

Marrëveshje me kompani të ndryshme përmes të cilave do të promovohen shërbimet tona dhe do të rriten përfitimet e ndërmarrjes.

Në vitin e ardhshëm planifikojmë shtimin e marrëveshjeve me kompani të ndryshme si banka komerciale, kompani private, institucionale e organizata të tjera për shfrytëzimin e shërbimeve të Trafikut Urban.

Këto marrëveshje do ju mundësojnë punëtorëve të këtyre kompanive të përfitojnë biletat vjetore me çmime promocionale dhe paralelisht me këtë edhe rritjen e përfitimit të ndërmarrjes dhe shfrytëzimit të shërbimeve tona. Kjo do të ndihmoj edhe në sensibilizimin e qytetarëve për shfrytëzimin e transportit publik duke ndikuar direkt në mbrojtjen e mjedisit dhe duke zvogëluar fluksin e veturave brenda kryeqytetit.

Disa nga këto marrëveshje janë gati për nënshkrim, ndërsa me shumë kompani të tjera jemi në negocim për arritjen e këtyre marrëveshjeve.

Trafiku Urban do të ofroj çmime promovuese të biletave vjetore për këto kompani, sikurse në rastin e marrëveshes në mes Komunës së Prishtinës dhe ProCredit Bank, pra kompania e cila nënshkruan marrëveshje me Trafikun Urban do të përfitojnë ofertë nga 10% deri në 20% zbritje, varësisht nga pesha e marrëveshjes dhe ndërmarrjes.

Në rast të kërkesave specifike me oferta më të larta se standardi i aplikuar, ndërmarrja do të paraqet kërkesën tek DSHP për miratim paraprak.



5. SWOT analiza

S

- Flota e autobusëve (Euro 6);
- Kontrata PSC;
- Struktura organizative;
- Përgatitja e stafit profesional;

- Shpejtësia e ulët mesatare;
- Mungesa e "Bus Lane";
- Mos pasja e autobusëve rezervë;


W

O

- Blerja e flotës së re të autobusëve;
- Zhvillimi i marketingut;
- Digitalizimi i proceseve në ndërmarrje;
- Rritja e mirëqenies së punëtorëve;

- Çmimi i derivateve;
- Migrimi i punëtorëve;
- Aksidentet në trafik;
- Trafiku i rënduar, humbja e nisjeve;

T



6. Drejtoria e Financave

Të hyrat e planifikuara për vitin 2024 janë të bazuara në operimin e pesëdhjetenjë (51) autobusëve aktual si dhe në operimin e tridhjetë (30) autobusëve të rinj që planifikohen të fillojnë punën në muajin tetor 2024.

Në vitin 2024 planifikohen të hyra në vlerë prej 10,055,306.87 euro, ndërsa duke u bazuar në prioritetet për një operim funksional, planifikohen shpenzime prej 8,649,573.46 euro si dhe një fitim operativ prej 183,235.27 euro.

Ndërmarrja planifikon Investime kapitale, bazuar në projekte konkrete, si investime efikase me një ROI (kthim të investimeve) të mirë.

Më poshtë do ta paraqesim planifikim buxhetor vjetor dhe strategjik për vitet 2024-2026.¹



Grafikoni nr. 1 – Planifikimi Strategjik për vitet 2024-2026

¹ Shtojca A: Pjesa Financiare - Plani i Biznesit për vitet 2024-2026

7. Drejtoria e Operativës

Departamenti i Operatives është i përbërë nga tre sektorë: Sektori i Transportit, Sektori i Mirëmbajtjes dhe Sektori i Shërbimeve Mbështetëse.

Ky departament përfshinë pjesën më të madhe të punësuarve në ndërmarrje dhe si i tillë e bartë pjesën më të madhe të punëve dhe aktiviteteve brenda ndërmarrjes.

7.1 Sektori i Transportit

Veprimtaria e ndërmarrjes është ndërlidhur drejtpërdrejtë me sektorin e transportit, që është përgjegjëse për organizimin dhe koordinimin e linjave, orareve dhe ekuipazhin e autobusëve.

Sektori Transportit është i përbërë prej një numri të lartë të punonjësve, puna e të cilëve është e lidhur ngushtë sipas hierarkisë së Sektorit.

Sektori i Transportit për vitin 2024 ka plan të detajuar të operimit vjetor të autobusëve në linjat ku Trafiku Urban operon sipas vendimit të Kuvendit Komunal të Prishtinës. Detajet e planit janë: Itinerari i qarkullimit të autobusëve në linja, rendi i udhëtimit si dhe kilometrat e planifikuara për operim duke ju përshtatur rregullave të kontratës PSC.

Përkthim i rendeve të udhëtimit si dhe koha e qarkullimit në linjat e TU-së

- Linja nr. 1, Prishtinë - Fushë Kosovë dhe anasjelltas.
 - Operon çdo dite nga ora 06:00-24:00.



- Linja nr. 1A, Prishtinë - Aeroport dhe anasjelltas.
 - Operon çdo ditë nga ora 07:00-24:00.




- Linja nr. 3, Rrethi i Matit - fshati.Bardhosh dhe anasjelltas.
 - Operon çdo ditë nga ora 06:00-24:00.



- Linja nr. 3B, Rrethi i Matit - fshati.Bërnicë e Ultë, është pjesë e linjës 3.
 - Operon çdo ditë nga ora 07:00-19:00.



- Linja nr. 3C,Bregu i Diellit - fshati.Sinidoll dhe anasjelltas.
 - Operon çdo ditë nga ora 06:00-22:00.



- Linja nr. 4, Lagja Mat - Parku i Gërmisë dhe anasjelltas.
 - Operon çdo ditë nga ora 06:00-24:00.



- Linja nr. 7C, Kalabri - Qendër dhe anasjelltas.
 - Operon çdo ditë nga ora 06:00-22:00.



- Linja nr. 15, Prishtinë - fshati. Prapashticë dhe anasjelltas.
 - Operon çdo ditë nga ora 07:00-19:00.



- Linja nr. 19, Prishtinë- Kishnicë dhe anasjelltas.
 - Operon çdo ditë nga ora 07:00-19:00.



7.1.1. Propozimet për linjave të reja

Trafiku Urban do të jetë i gatshëm që t'i ofroj bashkëpunim Sektorit të Mobilitetit në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike për propozimin e linjave të reja sipas nevojave dhe kërkeshave të arsyeshme të qytetareve për lagjet urbane dhe rurale në territorin e Komunës së Prishtinës.

7.1.2. Plotësimi funksionale dhe modernizimi i sistemeve të transportit

- Modernizimi i pajisjeve komunikuese në mes të dispeçerëve si dhe ekuipazhit të autobusëve.
- Trajnime për punëtorët e Sektorit të Mirëmbajtjes.
- Vendosja e pajisjeve sinjalizuese për persona me nevoja te veçanta.
- Vende të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara në autobusë.

7.1.3. Zgjerimi i zonave të operimit

Me shtimin e flotës me autobusë të rinj do të bëhet shpërndarja e tyre në linjat më të ngarkuara dhe planifikimi i linjave të reja në lagjet të cilat nuk janë të mbuluara aktualisht.

7.2. Sektori i mirëmbajtjes

Sektori i Mirëmbajtjes përbënë një nga sektorët kyç të mirëfunksionimit të zixinjinit të brendshëm operues dhe garanton disponueshmérinë dhe sigurinë teknike të flotës së autobusëve.

Kalendari i mirëmbajtjes mbetet udhërrëfyes i çdo veprimi dhe strategjia e organizimit mbështetet në mirëmbajtjen preventive sipas praktikave më të reja

Përgjatë muajit nga Sektori i Mirëmbajtjes kryhen dhjetëra kontrollime preventive për çdo autobus dhe shumë analiza statistikore në mënyrë që të parashikohet saktësisht amortizimi i autobusëve dhe planifikimi i kampanjave të ardhshme.

Në vazhdim mund ta shihni një nga analizat të cilat Sektori i Mirëmbajtjes i kryen përgjatë vitit, dhe ka të bëjë me matjen e saktë të sasisë së konsumuar të vajit nga motorët:





Figura 5.1 - Grafiku tregon mbi sasinë e konsumimit të vajit nga motorët e autobusëve të flotës

Përgjatë viteve Sektori i Mirëmbajtjes është përkujdesur për ruajtjen e imazhit të Kryeqytetit përmes mirëmbajtjes teknike dhe vizuale të autobusëve të Kryeqytetit.

Duke u nisur nga përvoja e krijuar dhe sukseset e treguara sot Sektori i Mirëmbajtjes paraqet shembullin dhe referencën se si duhet të organizohet mirëmbajtja teknike në transportin publik edhe për shtetet e tjera, e arritur e cila na jep besim dhe siguri për të ardhmen e ndërmarrjes.

Sektori i mirëmbajtjes si sektor që garanton sigurinë financiare të ndërmarrjes planifikon që të zgjeroj gamën e shërbimeve gjatë vitit 2024 duke ulur edhe më tej shpenzimet operative dhe njëkohësisht synon ta kthej Sektorin e Mirëmbajtjes në një Sektor që arkëton mjete financiare nga palët e treta për ndërmarrjen.

RRITJA E TË HYRAVE



Figurë 5.2. - Grafik që paraqet rritjen e të hyrave nga palët e treta

Disa nga investimet që parashihen të kryhen në arrijen e këtij qëllimi janë:

- Makinë për riparimin e injektorëve të naftës;
- Makinë për riparimin e turbinave;
- Makinë për rrafshimin e kokës së motorit;
- Makinë për pastrimin e pjesëve të karbonizuara;
- Makinë për pastrimin e filterëve të sistemit të emetimit të gazrave;
- Frezë NC;

Përmes Sektorit të Mirëmbajtjes gjatë vitit 2024 - 2026 parashihet që përmes përgatitjeve teknike dhe ligjore, Trafiku Urban të siguroj licencën dhe investimin kapital për zhvillimin e Sistemit të Kontrollës Teknike. Rrjedhimisht, do të krijohen kushtet që përveç kontrollimit teknik të mjeteve të ndërmarrjes, Trafiku Urban të shërbej si qendër e kontrollimit teknik për të gjitha mjeteve të institucioneve publike. Kjo do të kontribuonte në rritjen e të hyrave për ndërmarrjen.



Figura 5.3 - Sistem i kontrollës teknike që synohet të investohet në Trafikun Urban

Përmirësimi i kushteve të punës dhe avancimi i metodave të punës në Sektorin e Mirëmbajtjes është prioritet i ndërmarrjes për vitin 2024-2026. Kjo parashihet që përmes investimeve kapitale si; blerjen e automjetit për ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes në teren me mjetet tjera përcjellëse, rikonstruktimin e kanaleve të punës, funksionalizimin e njësisë së gomisterisë përmes blerjes së pajisjeve përmontim dhe balancim të gomave, konstruktimin e dhomës së riparimeve gjenerale të motorëve dhe të ndërruesve, si dhe shtrirjen e rrjetit pneumatik në hapësirat punuese, ndërmarrja të përfitonte duke kapitalizuar gjithë stafin profesional që posedon dhe krijonte të hyra financiare shtesë.

Për shkak të mos përshtatshmërisë për shfrytëzim dhe mos përmbytjes së kushteve të sigurisë të pompës aktuale të derivateve të naftës, është e nevojshme ri pozicionimi i pikës së derivateve dhe investimi në rregullimin e platformës.

Po ashtu, ridizajnimi i parkingut të autobusëve sipas standardeve mbetet domosdoshmëri për shkak të sigurisë dhe rritjes së numrit të autobusëve në 81.




Figura 5.4. - Formë e mundshme e organizimit të autoparkut

7.3 Renovimi i objektit dhe kiosqeve

Me qëllim të krijimit të kushteve me të mira për punëtorët, planifikojmë renovimin e objektit sipas projektit i cili është përgatitur nga NPB (Ndërmarrja Publike Banesore).



Figura 5.5. Pamje e hapësirës së brendshme



Figura 5.6. Pamje e hapësirës së jashtme

Renovimi i kiosqeve do të na ndihmojë në promovimin e shërbimeve që ofrojmë dhe në përmirësimin e kushteve për punonjësit që shërbejnë në këto pika të shitjes.



Figura 5.7. Pamje e kioskës

7.4 Sektori i Shërbimeve Mbështetëse

Sektori i Shërbimeve Mbështetëse kujdeset për pastrimin e autobusëve, mirëmbajtjen e ambienteve të punës dhe shërbimeve logistike.

Si synim zhvillimi Sektori i Shërbimeve Mbështetëse parashevë blerjen e makinës automatike për larjen e jashtme të autobusëve

Qëllimi i këtij projekti është ngritja e kapaciteteve në autolarje me makinë industriale, e cila do të mundësoj ngritjen e efikasitetit në larjen e autobusëve. Gjithashtu do të përmirësohen kushtet e punës për punëtoret e autolarjes dhe gjithashtu do të mundësoj ofrimin e shërbimeve për palët e treta dhe inkasimin e mjeteve financiare nga pastrimi i autobusëve dhe kamionëve privat.



Figurë 5.8. - Sistem i larjes automatike të autobusëve

8. Drejtoria e Administratës

8.1 Burimet Njerëzore

NPK “Trafiku Urban” SHA, aktualisht numëron 398 punëtorë, prej të cilëve 42 janë femra dhe 356 meshkuj, mosha mesatare e tyre është 41.80 vite.

Numri i Përgjithshëm i Punëtorëve

NUMRI I PËRGJITHSHËM I PUNËTORËVE	
Gjithsej:	398
Ndarja sipas departamentit/zyrës/sektorit	
Kryshefi Ekzekutiv	1
Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv	4
Kontrollor	14
Zyra Sekretarit	/
Zyra e Auditorit	/
Drejtoria e Financave	12
Drejtoria e Prokurimit	2
Drejtoria e Administratës	25
Drejtoria e Operativës	340

Klasifikimi i Punëtorëve Sipas Gjinisë

KLASIFIKIMI I PUNËTORËVE SIPAS GJINISË			
Mosha	Meshkuj	Femra	Gjithsej
18 - 25	26	3	29
26 - 35	70	14	84
36 - 45	115	11	126
46 - 55	74	10	84
56 - 65	71	4	75
Gjithsej	356	42	398

Klasifikimi i Punëtorëve Sipas Nivelit të Arsimimit

KLASIFIKIMI I PUNËTORËVE SIPAS NIVELIT ARSIMOR			
Niveli i Arsimimit	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Shkollim i Lartë	26	22	48
Shkollim i Mesëm	313	20	333
Shkollim Fillor	17	0	17
Gjithsej	356	42	398

Ndarja e punëtorëve Femra / Meshkuj Sipas Sektorëve

KLASIFIKIMI I PUNËTORËVE SIPAS GJINISË NË DEP./SEKTORE			
Dep./Sektori/Zyra	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Kryeshefi Ekzekutiv	/	1	1
Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv	2	2	4
Kontrollor	/	14	14
Zyra Sekretarit	/	/	/
Zyra e Auditorit	/	/	/
Drejtoria e Financave	7	5	12
Drejtoria e Prokurimit	/	2	2
Drejtoria e Administratës	9	16	25
Drejtoria e Operativës	24	316	340
Kontrata	42	356	398

Ne vitin 2024 - 2026 planifikojmë të organizojmë trajnime të ndryshme për punonjësit e ndërmarrjes.

Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve dhe përmirësimi i performancës janë disa nga arsyet e planifikimit të këtyre trajnimeve. Ky është qëllim kryesor i drejtorisë dhe ndihmon në zgjerimin e njojurive të punonjësve, duke kontribuar në rritjen e zhvillimit të ndërmarrjes.

Përgjithësisht, këto tema trajnimi do të na ndihmojnë si në aspektin strategjik po ashtu edhe në komunikimin e drejtpërdrejtë me punëtorët, në mënyrë që ti arrijnë me rezultate sa më të mira në punë.

Trajnimet do të fokusohen në ofrimin e informatave, që ndihmojnë të kuptuarit e rëndësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (MBNj) dhe zbatimit të tyre në praktikë.

8.2 Plani i Teknologjisë Informatike

Plani për digjitalizimin e përgjithshëm në ndërmarrje, i cili përfshin të gjitha shërbimet që i ofrojmë dhe ka ndikim ne te gjithë sektorët e ndërmarrjes, është synimi ynë dhe ka rol mjaft të rëndësishëm.

8.2.1 General Software

Krijimi i një programi të përgjithshëm të menaxhimit është njeri nga synimet kryesore të ndërmarrjes, ky program do të ketë ndikim në secilin proces të punës, do të lehtësoj dhe ngrit transparencën në zingjirin e shërbimeve operative dhe administrative. Qëllimi i këtij programi është kalimi nga sistemi i tanishëm i cili është i vjetër, në një sistem të avancuar më të lehtë për tu përdorur. Ky sistem mundëson gjenerimin e raporteve mbi të dhënat, detyrat dhe përgjegjësit e punonjësve, si dhe evidentimin e aseteve në depot e ndërmarrjes, procedura të cilat për momentin sjellin mjaft telashe përfundimin e procedurave në kohën e paraparë.

8.2.2 WiFi Falas në Autobusë

Marrëveshja për pajisjen e autobusëve me WiFi të cilën udhëtaret do të mund ta shfrytëzojnë falas është një nga hapat e duhur në epokën e tokologjisë dhe është një shembull konkret i përpjekjes tonë për të përmirësuar kushtet e udhëtimit.

8.2.3 Sistemi i Ri i Pagesës

Nga data 1 tetor 2023 ka filluar alternativa e re e blerjes së biletave me SMS përmes operatorëve telefonikë vendor Ipko dhe Vala. Nga statistikat e deritanishme vërejmë se kjo formë e re e pajisjes me biletë ka gjetur përdorim mjaft të gjërë te qytetaret që shfrytëzojnë shërbimet e Trafikut Urban. Për ti njoftuar qytetarët rrëth mënyrës së shfrytëzimit të këtij shërbimi kemi realizuar fushatë në forma të ndryshme, duke përfshirë vendosjen e posterëve në autobusë, në pritoret e autobusëve dhe në kiosket e Trafikut Urban si dhe shpërndarjen e tyre në rrjetet sociale.



Figura 5.9 Mënyra e pagesës përmes SMS

Në vitin e ardhshëm planifikojmë digitalizimin e plotë të shërbimeve i cili përfshinë pajisjen me biletë edhe në formë të tjera duke përfshirë përdorimin e kartelave elektronike, atyre bankare si dhe vendosjen e kiosqeve elektronike në pritoret e autobusëve.



Figura 5.10 Mënyra e pagesës përmes biletës digjitale

8.2.4 Sistemi Akustik në Autobusë

Planifikimi i projekteve për të ofruar shërbime të përshtatshme dhe përmirësuar qasjen e personave me aftësi të kufizuara.

Qëllimi ynë është që brenda vitit 2024 në autobusët e Trafikut Urban të instalohen pajisjet sinjalizuese me zë si dhe pajisjet vizuale në autobusë dhe në pritoret e qytetit.

8.3 Plani i Marketingut

Strategjia e Marketingut si pjesë përbërëse e Planit të Biznesit për vitin 2024 - 2026, në të cilën është paraqitur analiza e situatës aktuale dhe objektivat e ndërmarrjes për këtë periudhë. Në këtë strategji janë paraqitur aktivitetet e planifikuara të marketingut, që do të realizohen përmes komunikimit të integruar të marketingut.


Përmes marketingut synojmë të krijojmë burim të ri financiar dhe mundësi shtesë për përmirësimin e shërbimeve të transportit publik në Komunën e Prishtinës. Po ashtu, do të ishte mundësi e mirë të krijohet hapësirë për sjelljen e produkteve të reja të marketingut bashkëkohor, duke i bërë autobusët të shihen si një mundësi e mirë për reklamimin e bizneseve lokale në Komunën e Prishtinës. Kjo do të ndikonte në ngritjen e nivelit të shërbimeve dhe rrjedhimisht edhe në informimin më të mirë të shfrytëzuesve të autobusëve të Trafikut Urban përmes ekraneve digitale, të vendosur në autobusë.

Për të krijuar një lidhje të fortë me komunitetin dhe për të adresuar nevojat e tyre në planifikimet tona, krijimi i hapësirave të reja do të shtonte vlerën e planit tonë të marketingut.

Këto janë parakusht i arritjes së objektivave të ndërmarrjes në përgjithësi dhe në veçanti arritjes së objektivave të marketingut në Trafikun Urban.

8.3.1. Plani i promovimit të produkteve të reja

- Promovimi i aplikacionit të ridizajnuar për qytetarët;
- Promovimi i mundësive të barabarta të punësimit për femra dhe minoritete;
- Krijimi i strategjisë së marketingut;
- Zhvillimi i marketingut përmes autobusëve tanë në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës;
- Analiza e situatës dhe shqyrtimi i performancës operative të flotës aktuale të autobusëve (51 autobusë);
- Vlerësimi i performancës së stafit dhe analiza e rezultateve;
- Trajnim i punonjësve, me theks të veçantë në kujdesin ndaj udhëtarëve, komunikimin dhe cilësinë e shërbimit.



8.3.2. Rritja e kualitetit të shërbimeve

- Përmes implementimit të kontratës PSC, ekskluzivisht vlerësimit për muaj të shërbimeve të Trafikut Urban përmes indikatorëve synohet rritja e kualitetit të shërbimeve.
- Zgjatja e orarit të shërbimeve të transportit deri në mesnatë ndikon në rritjen e kualitetit dhe besueshmërisë, dhe rritjen e shfrytëzimit të transportit publik nga qytetarët.
- Implementimi i matjes së kënaqshmërisë së udhëtarëve përmes pyetësorëve në autobusë, ku synohet ngritja e cilësisë së shërbimeve.
- Implementimi i sistemit të trajtimit të ankesave në kohë.
- Matja e performancës së punëtorëve të ndërmarrjes në mënyrë që të rritet përgjegjësia ndaj detyrave të punës dhe shërbimeve.

8.3.3. Digjitalizimi i biletave

Implementimi i këtij sistemi paraqet qasje më të lehtë në shfrytëzimin e transportit publik në Kryeqytet e po ashtu në rritjen e numrin të qytetarëve që shfrytëzojnë transportin publik.

Promovimi i aktiviteteve


- Informimi i qytetareve përmes metodave dhe aktiviteteve të poshtë cekura:
 - Ueb faqes zyrtare;



- Aplikacionit mobil;

Që qytetaret të jenë sa me afër informacionit për linjat dhe oraret e autobusëve është lansuar aplikacioni mobil që mund të shkarkohet lehtë në IOS dhe Android për të pasur qasje në vendndodhje të autobusëve sipas linjave dhe orareve.

- Rrjetet sociale:



Shpërndarja e informacioneve për qarkullimin e autobusëve në rrjetin e linjave të TU -së:


TrafikuUrban
PRISHTINË

+383 45 10 11 28
Trafiku Urban Prishtinë

+383 45 10 11 23
+383 45 10 11 22

info@trafikurban-pr.com

LINJA NR. 1 (Prishtinë -> Fushë Kosovë)

Nisjet nga Fakultetit Teknik (Prishtinë)						Vendstacionet
6:00	6:20	6:40				Fakulteti Teknik
7:00	7:10	7:20	7:30	7:40		Konviktet
7:50						Ministria e Arsimit
8:00	8:15	8:30	8:50			Prapa Teatrit
9:10	9:30	9:45				"Plepat"
10:00	10:15	10:30	10:45			"Qafa"
11:00	11:15	11:30	11:45			NEW BORN
12:00	12:15	12:30	12:40	12:50		Katedralja
13:00	13:15	13:30	13:45			Dardania
14:00	14:15	14:30	14:45			Lakrishtë
15:00	15:15	15:30	15:40	15:50		FSK
16:00	16:15	16:30	16:45			Amortizatorët
17:00	17:15	17:30	17:45			"ETC"
18:00	18:15	18:30	18:50			Mobileria "EREZA"
19:10	19:30	19:50				Hotel "Semitronix"
20:10	20:30	20:50				Apollonia
21:10	21:30	21:50				SH.M.L. "M. Gremeno"
22:20	22:40					BESI Rreglazhë
23:00	23:20	23:40				Cerdhja
24:00						Rrethi F. Kosovë
						Posta
						St. Hekurudhor

LINJA NR. 1 (Fushë Kosovë -> Prishtinë)

Nisjet nga Stacioni Hekurudhor (Fushë Kosovë)						Vendstacionet
6:10	6:30	6:50				St. Hekurudhor
7:05	7:15	7:25	7:35	7:45		Shtëpia e Kultures
7:55						Posta
8:07	8:22	8:40				Rrethi F. Kosovë
9:00	9:20	9:37	9:52			Përballi i Cerdhes
10:07	10:22	10:37	10:52			Mbikalimi
11:07	11:22	11:37	11:52			"Apollonia"
12:07	12:22	12:35	12:45	12:55		"Bau Market"
